

Dituria – Albania

Dubravka Ugrešić

Muzeumi i kapitullimit pa kushte

Muzej bezuvjetne predaje

Përktheu Ilira Shurbani - Ymeri



Ulomak:

Një natë në Lisbonë

Gjëja e parë që më ra ndër mend në lidhje me Lisbonën, një qytet ku do të shkoja për herë të parë, ishte titulli i një romani të vjetër të Remarkut, *Një natë në Lisbonë*. Romani i Remarkut lidhet me kohën tashmë të harruar kur “njeriu nuk vlente asgjë” dhe “një pasaportë e vlefshme, gjithçka”. E ndesha atë citim ndërsa prisja disa orë në një zyrë të Berlinit Perëndimor, për të zgjatur vizën time gjermane dhe pastaj nja dy orë në zyrën e vogël të konsullatës portugeze të Berlinit Lindor me Remarkun në dorë. Në pasaportën time të zbukuruar mirë me viza, viza e bukur portugeze dukej premtuese.

Udhëtova për në Lisbonë me një sasi të madhe bagazhesh, ose krejtësisht pa bagazhe, varet si ta merrje. Kisha humbur atdheun tim. Nuk isha mësuar ende me humbjen, as me faktin se atdheu im ishte po ai, por i ndryshëm. Pikërisht brenda një viti kisha humbur shtëpinë, miqtë, punën, mundësinë për t’u kthyer së shpejti, por gjithashtu dëshirën për t’u kthyer. Në tërësi, një histori tepër e gjatë për t’u treguar këtu. Në moshën dyzetepesëvjeçare u gjenda në botë me një çantë që përmbante sendet më thelbësore, sikur bota të ishte një strehim nga bombardimet. Kujtimet e mia për strehimet ku shkoja bashkë me bashkatdhetarët e mi gjatë paralajmërimeve të sulmeve ajrore ishin ende të freskëta. Ndonjëherë bagazhi më dukej tepër i rëndë, ndonjëherë tmerrësisht i lehtë,

ndjenjat e mia vareshin nga humori i çastit. Zakonisht përpiqesha ta masja humbjen me një shkallëzim imagjinar, të përgjithshëm, që mund të ishte ngushëllues.

Sepse Europa ishte plot me njerëz si unë, i ndeshja bashkatdhetarët e mi kudo që shkoja: boshnjakë, kroatë, serbë... Historitë tona ishin të ndryshme, por në fund të gjitha përfundonin në të njëjtën gjë. Në të vërtetë, e kisha shkatërruar vetë "shtëpinë" time. Nuk kisha vënë re faktin se "lufta dhe diktatura janë motra", të cilin Remarku e dinte. Po, kisha shkruar diçka që nuk duhej ta shkruaja. Ashtu bëra, e pranoj, më shumë nga një paaftësi për t'iu përshtatur një gënjeshtre të përgjithshme, sesa nga dëshira për të qenë një hero. Kisha arritur në një moshë kur gënjeshttrat qenë të pranueshme vetëm në letërsi, në art, si një strategji e ligjshme, por jo në jetë.

Si bashkërefugjatët e shumtë nga vendi im isha e trembur përballë së ardhmes së pasigurt në të cilën e vetmja gjë e sigurt ishte një pasaportë me përdorim të shkurtër. Po të kisha qenë kriminele, ndoshta pikërisht një pasaportë e tillë do të kishte qenë e vlefshme, por unë isha shkrimtare. Sidoqoftë, nuk e mora "fatin" tim dramatikisht. Librat e mi po fillonin të shfaqeshin në sigla të thjeshta të botuesve në gjuhë të huaja. Për këtë arsye më kishin ftuar në Portugali në një takim dy ditor letrar.

E prirur nga një ide romantike për Lisbonën, iu luta mikpritësve të mi të më rezervonin një dhomë të lirë hoteli disa ditë përpara fillimit të takimit. Doli se hoteli nuk ishte aq i lirë. Në vend të një *pensão* të vogël, romantik, të vjetër (që kisha përfytyruar) përfundova në një hotel mjaft të ri me një pamje të rëndomtë që i ngjante në çdo gjë atyre europianolindore. Zona e sportelit, bari i vogël dhe korridoret ishin mbushur me erën e ndenjtur të tymit të duhanit. Unë mbërrita një të premte në mbrëmje, takimi letrar nuk filloi deri të mërkurën vijuese. Te sporteli ndodhej një zarf me para që më priste, pagesa ime, e lënë nga mikpritësit e mi të kujdesshëm. Rua Kastilho ishte i zbrazët, po binte një muzg i pisët, me erë dhe i lagësht.